



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2499/2 Prot.

Tiranë, më 14.08.2023

VENDIM

Nr. 49, datë 14.08.2023

PËR
“MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 DHE
TREGUESVE TË BUXHETIT TË VITIT 2024, PËR
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2018 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; në ligjin nr.10296, 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; në Udhëzimin Plotësues nr. 22, datë 07.07.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”; në Rregulloren e Brendshme, “Për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”; të ndryshuar; në Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; në Vendimin e Rektoratit dhe GMS-së nr. 03, datë 04.08.2023 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe treguesit e vitit 2024, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”; në Vendimin e Senatit Akademik nr. 89, datë 07.08.2023 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe treguesit e vitit 2024, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, pasi mori në shqyrtim relacionin e grupit EMP, të dërguar me shkresën e Administratorit të UMT-së nr.1692/25 prot., datë 07.08.2023 “Dërgohen për miratim treguesit e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, në mbledhjen e datës 14.08.2023, Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Të miratojë programin buxhetor afatmesëm për vitet 2024-2026, për Universitetin e Mjekësisë Tiranë, sipas tabelave bashkëlidhur këtij vendimi, Aneksi 7A.
2. Të dakordësojë treguesit e buxhetit të vitit 2024 të parashikuar në PBA 2024-2026.
3. Rishikimi i tyre do të kryhet me ardhjen e grantit buxhetor dhe rakordimin e të ardhurave të trashëgueshme.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI

ANËTARË

MONIKA FIDA

VERA OSTRANI

ALTINA XHAFERI

ANIS THODHORJANI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRI YZEIRAJ